

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA



Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 01.02.2016 jep këtë

Mendim juridik

Sipas dispozitës së nenit 253 par. 5 të LPK, paditësi që nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar sipas vlerës së kontestit me padi edhe pas dorëzimit të vërejtjes për pagesën e saj dhe, kur nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga detyrimi i pagesës së saj, atëherë do të konstatohet se padia është tërhequr.

A r s y e t i m i

- (1) Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpçë, me parashtrësën e datës 09.12.2015, ka paraqitur dilema dhe paqartësi se a të interpretohet dhe implementohet neni 253, par. 5 të LPK lidhur me pagesën e taksës gjyqësore që nëse paditësi që nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar sipas vlerës së kontestit me padi edhe pas dorëzimit të vërejtjes për pagesën e saj dhe, kur nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga detyrimi i pagesës së saj, atëherë do të konstatohet se padia është e tërhequr apo të zbatohet neni 6.5 i Udhëzimit Administrativ nr.2008 të datës 26.12.2008, me ndryshimet dhe plotësimet e tij nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas të cilit nen, pasi që edhe njëherë t'i tërhiqet vërejtja për pagesën e kësaj takse, padia e paditësit do të hidhet poshtë.
- (2) Me dispozitën e nenit 253, par. 5 të LPK saktësisht dhe qartësisht parashikohet:


citat;

Nëse edhe pas vërejtjes së pranuar nga gjykata, paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore sipas vlerës së kontestit të përcaktuar në padi, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Mbarim citati

- (3) Duke bërë interpretimin kritik kreativ përmbajtjesor, me pa mëdyshje, rezulton se pasi që paditësit t'i tërhiqet vërejtja për pagesën e taksës gjyqësore sipas vlerës së kontestit të përcaktuar në padi, nuk e paguan atë dhe nuk janë përmbushur kriteret ligjore për lirim nga detyrimi i pagesës së saj, atëherë gjykata me aktvendim konstaton se padia është tërhequr.
- (4) Formulimet juridike nga korpusi i nenit 6.5 të Udhëzimit Administrativ nr.2008 të datës 26.12.2008 me ndryshimet dhe plotësimet e tij nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës me të cilin parashikohet tërheqja e serishme e vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore, padia e paditësit do të hedhet poshtë, bie ndesh me dispozitën e nenit 253, par. 5 të LPK. dhe kjo dispozitë nga udhëzimi i referohet parashtrësave në përgjithësi, ndërsa për taksën në padi bënë fjalë neni 253.par.5. e LPK.
- (5) Duke qenë se neni 6.5 i këtij Udhëzimi Administrativ është në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 253, par. 5 të LPK, atëherë zbatohet kjo dispozitë ligjore e LPK dhe rrjedhimisht neni 6.5 i Udhëzimit Administrativ është nul.

Prof. Dr. Fejzullah Hasani



Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës